



Stadi: 01/09/2017

### Aplikim për vizë me qëllim kualifikimi ose praktike

Lutemi të lexoni me kujdes këtë fletë-informacioni dhe formularin e aplikimit dhënë bashkëngjitur. Duke qenë i/e përgatitur mirë ju mund të ndikoni pozitivisht dhe të shkurtoni procedurën përkatëse.

#### I gjithë dokumentacioni duhet të paraqitet në origjinal!

Në rastin e aplikimit për vizë Ambasada, si rregull, duhet të përfshijë në procedurë Agjencinë Federale të Punës (ZAV) dhe në raste të veçanta edhe zyrën përkatëse për të huajt në Gjermani. Për këtë arsye procedurat zgjasin zakonisht deri në 8 javë, në raste të veçanta edhe më shumë se kaq.

Të gjitha dokumentat që tërhiqen pranë Ambasadës (fletët e informacionit, formularët e aplikimit) janë gratis. Të gjitha informacionet rreth procedurës së aplikimit i gjeni në faqen e internetit të Ambasadës.

Lutemi të vini re udhëzimet e dhëna për çdo pikë, në mënyrë të veçantë numrin e kopjeve të nevojshme.		
1.	<b>Pashaporta e udhëtimit</b> <i>+ 2 kopje (të gjitha faqet e rëndësishme)</i>	Me të paktën dy faqe bosh. Lutemi mbani në konsideratë që afati i vlefshmërisë së pashaportës duhet të jetë tre muaj më i gjatë se kohëzgjatja e vizës. Fotokopjoni ju lutem fletën e plastifikuar me të dhënat personale.
2.	<b>2x formularë aplikimi për vizë</b>	Në gjermanisht ose anglisht, të plotësuara në mënyrë plotësisht të lexueshme, të nënshkruara personalisht.
3.	<b>3x fotografi</b>	3 fotografi identike biometrike për pashaportë, jo më të vjetra se 6 muaj.
4.	<b>Tarifa</b>	Tarifat dhe detyrimet duhet të paguhet <b>kesh në monedhën shqiptare LEK</b> . Tarifa është 75 Euro përlllogaritur me kursin aktual të këmbimit.
5.	<b>Kontratë e nënshkruar kualifikimi ose praktike</b> <i>+ 2 kopje</i>	Kontrata e kualifikimit ose e praktikës në origjinal, duhet të përmbajë të dhëna të sakta sa më poshtë: Lloji, përmbajtja dhe kohëzgjatja e veprimtarisë së synuar, koha e punës, vendi i punës, vlera e pagës. Nëse prej kontratës nuk rezulton përmbajtja e kualifikimit / praktikës së synuar,

		duhet të paraqitet një plan më vete i kualifikimit/praktikës.	
6.	<b>Dëshmi kualifikimi</b> <i>+ 2 kopje</i>	P.sh. diploma, dëshmi të përkthyer dhe dëshmi për gjuhën e kualifikimit.	
7.	<b>Curriculum Vitae (nëse kërkohet)</b> <i>+ 2 kopje</i>	Curriculum Vitae i formuluar nga vetë aplikuesi, duke paraqitur në mënyrë të veçantë kualifikimin dhe eventualisht veprimtarinë profesionale të deritanishme.	
8.	<b>Dëshmi e gjuhës gjermane</b> <i>+ 2 kopje</i>	Dëshmi për përvetësimin e suksesshëm të njohurive të gjuhës gjermane minimalisht në nivelin A2 osë vërtetim nga qendra e punës, që njohuritë e gjuhës në nivelin A2 nuk janë të nevojshme (dhe pse)	
9.	<b>Eventualisht dëshmi për një siguracion shëndetësor të mjaftueshëm</b> <i>+ 2 kopje</i>	Kjo dëshmi duhet të paraqitet, vetëm nëse prej kontratës së punës nuk rezulton se është punëdhënësi, ai që e merr përsipër siguracionin shëndetësor.	
10.	<b>Eventualisht dëshmi për financa të mjaftueshme për jetesën</b> <i>+ 2 kopje</i>	Nëse paga gjatë kualifikimit / praktikës nuk arrin vlerën e 800,-- eurove në muaj, atëherë është e nevojshme një dëshmi për diferencën e munguar si p.sh. përmes paraqitjes së një deklarate garancie <u>ose</u> dëshmisë së hapjes së një llogarie bankare të bllokuar. Për këto dhe të tjera mundësi financimi shihni faqen e internetit të Ambasadës Gjermane <a href="http://www.tirana.diplo.de">www.tirana.diplo.de</a>	

**Klauzolë e përjashtimit nga përgjegjësia:**

Të gjitha informacionet e mësipërme përcillen pa garancinë se janë të sakta apo të plota. Ato bazohen në stadin informativ të Ambasadës në momentin e hartimit të tyre.